

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.06.2023*

**09.06.2023
Ora 12:02**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për
Këshillat e Bashkive Lezhë, Tropojë, Kurbin për zgjedhjet për organet e qeverisjes
vendore të datës 14 Maj 2023”.**

PJESËMARRJA :

- **KQZ:** **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi KQZ:** **Z. Ylli Merkaj, Znj. P. Doçaj**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita atëherë, në seancën e sotme në rend dite kemi çështje që lidhen me shpërndarjen e mandateve për anëtarë të këshillit bashkiak në disa bashki, si dhe shqyrtimin e një kërkesë që lidhet me verifikim e thelluar për një kandidat për kryetarë bashkie.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit, bazuar në nenin 19 pika 1, shkronja “i” e Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve të zgjedhjeve për Këshillat Vendor si dhe jep mandatet për çdo kryetar bashkie të territorit të cilat ndahen në më shumë se 1 KZAZ, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si dhe KZAZ-të përkatëse të Bashkisë Lezhë, Tropojë dhe Kurbin kanë miratuar tabelat përmbledhëse të rezultatit, kundër këtyre vendimeve janë bërë ankim dhe pas përfundimit të procedurave ankimore janë pasqyruar rezultatet e dala nga këto procedura ankimore, në përfundim rezultati për subjektet zgjedhore, renditja e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit si dhe shpërndarja e mandateve është bërë

**Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.06.2023*

në bazë të nenit 162 pika 1,2,4 dhe 5 të Kodit Zgjedhor, referuar nenit 161 pika 1 dhe 166 pika 3 e Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit për sa më sipër, këto tabela KQZ-ja përlllogarit shpërndarjen mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt në bazë të renditjes së listave shumemërore të subjekteve zgjedhore të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, KZAZ-të në rastet përkatëse, për këto arsye në bazë të nenit 91 dhe 19 pika 1 shkronja “i” e Kodit Zgjedhor i propozojmë Komisionerit Shpërndarjen e mandateve të subjekteve zgjedhore, për zonën zgjedhore Bashkia Lezhë, Tropojë dhe Kurbin, bashkëlidhur keni pprojektvendimet për shqyrtim e miratim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, atëherë shpërndarja e mandateve për këshillin e Bashkisë Lezhë është si vijon:

Koalicioni Bashkë Fitojmë 6 mandate,
Partia Socialiste e Shqipërisë 9 mandate,
Partia Agrare Ambientaliste 1 mandat,
Partia Republikane 2 mandate,
Partia Lëvizja e Legalitetit 1 mandat,
Partia Demokracia Sociale 1 mandat,
Partia Socialdemokrate 7 mandate,
Partia Demokratike 2 mandate,
Fryma e Re Demokratike 1 mandat,
Aleanca Arbnore Kombëtare 2 mandate,
Partia Uniteti Kombëtar 2 mandate,
Partia e Gjelbër 2 mandate,

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.06.2023*

Partia Kristiandemokrate 4 dhe Ardhmëria Shqipëtare 1 mandat. Për Bashkinë

Tropojë shpërndarja është si vijon:

Koalicioni Bashkë Fitojmë 4 mandate,

Partia Socialiste e Shqipërisë 4 mandate,

Partia Agrare Ambientaliste 1,

Partia Republikane 1,

Partia Lëvizja e Legalitetit 1,

Partia Demokracia Sociale 1,

Partia Socialdemokrate 1,

Partia Progresiste LZHK 1,

Partia Aleanca Demokratike 1,

Bindja Demokratike 1,

Aleanca Arbnore Kombëtare 1,

Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet 2,

Lëvizja Punëtore Shqipëtare 1,

Partia e Unitetit Kombëtar 1, për këshillin e Bashkisë Kurbin shpërndarja e mandateve ndërmjet subjekteve është si vijon:

Koalicioni Bashkë Fitojmë 6 mandate,

Partia Socialiste e Shqipërisë 9 mandate,

Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë 1,

Partia Republikane 2,

Partia Lëvizja e Legalitetit 1,

Partia Demokracia Sociale 2,

Partia Socialdemokrate 3,

Partia Demokratike 1,

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.06.2023*

Aleanca Progresiste LZHK 1,
Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet 1,
Partia e Gjelbër 1,
Partia Kombëtare Konservatore Albania 1, ka fituar 1 mandat kandidati i mbështetur nga zgjedhësi zoti Diogjin Koliçi si dhe kandidati po i mbështetur nga zgjedhësi Renaldo Pirolio.

Vendimi nr. 662 - 664

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



**09.06.2023
Ora 12:06**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për Verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Miftar Tahir Dauti, Kryetar Bashkie i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për Bashkinë Has”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:** Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. P. Doçaj
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Në zbatim të nenit 138 të vitit 2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin e verifikimit, zbatimin dhe ndalimin për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin e formularit të deklarimit të disa subjekteve në të cilët edhe kryetarët e bashkive. Me vendim të KZAZ-së zoti Myftar Tahir Dauti është regjistruar si kandidat për kryetar bashkie, Bashkia Has i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni Bashkë Fitojmë i cili ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër nik “kupf”, 14 mijë e 384, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga drejtorja e përgjithshme e burgjeve, ku në përgjigje të kërkesës sonë Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve ka informuar se kandidati në fjalë rezulton i rehabilituar, nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se subjekti i

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.06.2023*

vetëdeklaruar i është përgjigjur “jo” të gjitha pyetjeve të pyetsorit të formularit të vetëdeklarimit, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Kordinimit institucional i është drejtuar Komisionit Qendror të zgjedhjeve me një kërkesë, me informacion se instituti i studimeve politike kërkon verifikimin e të dhënave të plotësuara në formularin e deklarimit të këtij subjekti vetëdeklarues, referuar kërkesës pretendohet se zoti Myftar Tahir Dauti rezulton të jetë i dënuar në shtetin e Kosovës, në shtetin Serbis dhe në Shqipëri. Në vlersim të kërkesës prokurorisë së përgjithshme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çmon se është e nevojshme marrja e informacionit shtes në lidhje me faktet që lidhen me autoritetet dhe vendet e huaja. Referuar nenit 8 pika 1, ligjit numër 138 të vitit 2015 është prokuroria e përgjithshme organi kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra në formularin e deklarimit, nisur nga sa më sipër i propozojmë Komisionerit kryerjen e verifikimit të thelluar duke dërguar dosjen dhe formularin prokurorisë së përgjithshme, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Mirë dakord, atëherë do të fillojmë procedurat për verifikimin e thelluar për kandidatin... për subjektin vetdeklarues zotin Miftar Tahir Dauti, kryetar bashkie, Bashkia Has propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni Bashkë Fitojmë duke dërguar të dhënat përkatëse në prokurorinë e përgjithshme për vlersim të mëtejshëm, ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe të Sanksioneve, brenda tre ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi, mirë çështje të tjera nuk kemi faleminderit seanca mbyllet.

Vendimi nr. 665

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

